



**BANKA E SHQIPERISE
KOMITETI KOMBETAR I PAGESAVE**

MARRËVESHJE

Nr. 7 Datë 20.03.2000

PËR

**NJOHJEN DHE PËRDORIMIN E
“URDHËR PËR DEBITIM DIREKT” (*DIRECT DEBIT*) &
“URDHËR PËR PAGESË PERIODIKE” (*STANDING-ORDER*)**

Tiranë

Objekti :

Futja në përdorim dhe unifikimi i mjeteve të pagesës “*Urdhër për pagesë periodike*” dhe “*Urdhër për debitim direkt*” në sistemin bankar shqiptar.

Qëllimi :

- Krijimi i lehtësive klientit në aktivitetin e tij në fushën e pagesave.
- Përmirësimi i shërbimit ndaj klientit dhe rritja e besimit të tyre ndaj bankave.

Mbështetur në :

- Ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren “Për sistemin dhe instrumentat e pagesave”, miratuar me Vendimin Nr. 148, datë 21.11.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

I. “URDHËR PËR PAGESË PERIODIKE”

“**Urdhër për pagesë periodike**” (*Standing-order*) - Instruksion me shkrim që një klient i jep bankës së vet për të realizuar një pagesë periodike, për një shumë të caktuar kundrejt një përfituesi të caktuar. “*Standing-order*” nënkupton që pagesat e kryera në periudha kohë të paracaktuara, janë në shumën e njëjta (p.sh. kështu e kredisë, primet e siguracionit, qeratë, etj.).

A. Forma dhe elementët e domosdoshëm (Formulari A 1-1)**1. Pjesa e përparme**

- Logo e bankës.
- Kodi i identifikimit të bankës.
- Emri i klientit urdhërues.
- Numri i llogarisë së klientit urdhërues.
- Emri i klientit përfitues.
- Emri i bankës së klientit përfitues.
- Numri i llogarisë së klientit përfitues.
- Shuma e pagesës.
- Data e ekzekutimit (datë-valuta).

- Arësyeja e pagesës.
- Arsyeja e anulimit (në se do të bëhet anulimi i marrëveshjes).
- Nënshkrimi (klienti urdhërues, banka).
- Vendi dhe Data.
- Kohëzgjatja e marrëveshjes.
- Komisionet bankare.
- Të dhëna të tjera për përdorim të brendshëm.

2. **Pjesa e prapme** (*Përgjegjësitë e palëve*)

Banka merr përsipër :

- Të Debitojë në datën e caktuar llogarinë e klientit dhe të transferojë shumën tek përfituesi;
- Të përgatisë nxjerrjen e llogarisë dhe njoftimin për klientin.

Klienti merr përsipër :

- Të ketë llogari pranë bankës.
- Të ketë tepricë të mjaftueshme në llogari.
- Në rastet e mosekzistencës të kësaj teprice ai është i detyruar të pranojë të gjitha penalitetet që rrjedhin nga ana e kreditorit për mos pagimin në kohë të detyrimit.
- Të kërkojë kryerjen në kohë të pagesave të përcaktuara nga banka dhe të kërkojë informacion ekstra kundrejt komisioneve përkatëse të bankës.

Secila bankë, në funksion të kushteve të punës, ka të drejtë të përcaktojë edhe elementë të tjerë shtesë, përveç elementëve të domosdoshëm që përmenden më sipër.

B. Përdorimi

“Urdhëri për pagese periodike” dorëzohet nga klienti urdhërues tek banka e tij. Kjo e fundit debiton llogarinë e klientit dhe krediton atë të përfituesit. “Urdhëri për pagese periodike” shërben në të njëjtën kohë edhe si marrëveshje (kontratë) mes klientit urdhërues dhe bankës për të përdorur këtë instrument. Anullimi i marrëveshjes mund të bëhet jo më pak se dy ditë pune përpara datës së kryerjes së pagesës së rradhës.

II. “URDHËR PËR DEBITIM DIREKT”

“Urdhër për debitim direkt” (*Direct debit*) - është pagese e autorizuar, e përdorur për pagimin e detyrimeve që lindin nga përdorimi i shërbimeve publike (të tilla si energji elektrike, ujë, telefon, gas, etj.). Në përgjithësi, i detyruari firmos një marrëveshje paraprake, me anë të së cilës i jep bankës ku ai mban llogarinë, të drejtën e debitimit të kësaj llogarie për shumën për të cilën ai detyrohet, në një datë të përcaktuar.

A. Forma dhe elementët e domosdoshëm (Formulari A 2-1)

1. Pjesa e përparme

- Logo e bankës.
- Kodi identifikimit të bankës.
- Emri i klientit përfitues (kreditori).
- Numri i llogarisë së kreditorit.
- Emri i klientit të detyruar për të paguar (debitori).
- Banka dhe Kodi i Identifikimit Bankar, të bankës së debitorit.
- Numri i llogarisë së debitorit.
- Shuma e pagesës (fatura që shpreh detyrimin e ndërmarrjes....)
- Data e ekzekutimit (datë-valuta).
- Arsyeja e pagesës.
- Arsyeja e anulimit (në se do të ketë anulim të marrëveshjes).
- Nënshkrimi (kreditori, banka).
- Vendi dhe Data.
- Kohëzgjatja e marrëveshjes.
- Komisionet bankare.
- Të dhëna të tjera për përdorim të brendshëm.

2. Pjesa e prapme (Përgjegjësitë e palëve)

Banka merr përsipër :

- Të debitoje në datën e caktuar llogarinë e debitorit dhe të transferojë shumën tek llogaria e kreditorit.
- Të përgatisë nxjerrjen e llogarisë dhe njoftimin për klientin.
- Të njohë debitorin me kushtet e kontratës me kreditorin.

Debitori merr përsipër :

- Të ketë llogari pranë bankës.
- Të ketë tepricë të mjaftueshme në llogari.
- Në rastet e mosekzistencës të kësaj teprice ai është i detyruar të pranojë të gjitha penalitetet që rrjedhin nga ana e kreditorit për mos pagimin në kohë të detyrimit.
- Të kërkojë kryerjen në kohë të pagesave të përcaktuara nga banka dhe të kërkojë informacion ekstra kundrejt komisioneve përkatëse të bankës.

Cdo bankë është e lirë të përcaktojë edhe kushte të tjera shtesë.

B. Përdorimi

“Urdhëri për debitim direkt” plotësohet dhe dorezohet nga debitori tek banka e tij dhe shërben në të njëjtën kohë edhe si kontratë/autorizim mes tij dhe bankës. Në rast se klienti kërkon anulimin e këtij urdhëri, ai duhet ta bëjë këtë, minimalisht dy ditë pune përpara datës së kryerjes së pagesës së radhës.

Banka nga ana e saj, nënshkruan një kontratë me kreditorin, për përdorimin e këtij instrumenti pagese. Kontrata mund të ndryshohet sipas kushteve që parashikohen në marrëveshje mes palëve (bankës dhe kreditorit). Nëpërmjet kësaj kontrate, Kreditori kërkon likuidimin e detyrimit, pranë bankës së debitorit, duke e justifikuar këtë me faturen përkatëse të shërbimit të kryer. Banka e debitorit - debiton llogarinë e tij, duke kaluar shumën përkatëse në llogarinë e kreditorit.

Kreditori merr përsipër :

- Të njoftojë debitorin për shumën që detyrohet të paguajë, jo më pak se 10 (dhjetë) ditë kalendarike përpara datës në të cilën duhet kryer pagesa (datës së shënuar në faturë, datë-valuta).
- Të sigurojë që njoftimi për debitorin të jetë identik me instruksionet e dërguara bankës.
- Në se debitori nuk pajtohet me njoftimin, ai mund të kontaktojë me kreditorin i cili mund të instruktojë bankën për të ndërprerë transaksionin e debitimit direkt. Ky njoftim duhet bërë jo më vonë se dy ditë pune para datë-valutës.

Banka merr përsipër :

- Të debitojë në datën e caktuar llogarinë e debitorit dhe të transferojë shumën tek kreditori.
- Të përgatisë nxjerrjen e llogarisë për debitorin dhe të njoftojë kreditorin.

IV. TË FUNDIT

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 15 dite pas nënshkrimit të saj nga shumica e thjeshtë e bankave të nivelit të dytë që janë anëtare të Komitetit Kombëtar të Pagesave.
2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo shfuqizohet me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të bankave nënshkruese të saj.
3. Bankat e nivelit të dytë, nënshkruese të kësaj Marrëveshje, bien dakort që mosmarrëveshjet midis tyre për gjithçka parashikohen ajo, t'i zgjidhin në mirëkuptim, në rast të kundërt ato do të pranojnë vendimin e Bankës së Shqipërisë për çdo rast konkret.
4. Banka e Shqipërisë i propozon nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje çdo banke që krijohet rishtas si bankë e nivelit të dytë dhe pranohet si anëtare e Komitetit Kombëtar të Pagesave.

BANKAT NËNSHKRUESE

1. **BANKA E SHQIPËRISË** _____
2. **BANKA KOMBËTARE TREGTARE** _____
3. **BANKA E KURSIMEVE** _____
4. **BANKA ARABO ISLAMIKE SHQIPTARE** _____
5. **BANKA ITALO-SHQIPTARE** _____
6. **BANKA DARDANIA** _____
7. **BANKA TIRANA** _____
8. **BANKA KOMBËTARE GREKE** _____
9. **BANKA NDËRKOMBTARE TREGTARE** _____
10. **BANKA ALPHA CREDIT** _____
11. **BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË** _____
12. **BANKA E PARË E INVESTIMEVE** _____
13. **BANKA FEFAD** _____
14. **BANKA NDERTREGTARE** _____